

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama i drejtohet: Mos e lini në baltë Ballkanin - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/rama-i-drejtohet-mos-e-lini-ne-balte-ballkanin/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 09:10:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c47e606ee1a7dfa716ceb939452dbbcaa51362c309aecdfbd498c4d1423a551
TEKSTI	650718d2931de73bfcca9d937f6a74e9f7b3523a91ef522ac510f8df7f135577
PAMJA	c1527e159368919f5df338cc350d4ca6c0bd4cc99e8846a65c5b045a6a216671

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	71ed10a97bf7ba2de6793f69e5b87a328f29cfd4446679a3f26e039b18699bd9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/71ed10a97bf7ba2de6793f69e5b87a328f29cfd4446679a3f26e039b18699bd9

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Edi Rama BE Pagat e gjyqtarëve Këshilli i Sigurisë Kombëtare

LAJM KRYESOR | POLITIKË

Rama i drejtohet: Mos e lini në baltë Ballkanin

28 Shtator 2026 | 11:07

Kryeministri Edi Rama ka folur për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë në Konferencën Ndërparlamentare "Agjenda strategjike për zgjerimin e BE-së dhe anëtarësimin e Shqipërisë", ku u ndal edhe te klima sociale dhe politike në vend.

Duke iu referuar protestave të "Revolucionit Flamingo", Rama tha se ato janë bërë një shembull i rritjes së pritshmërive të qytetarëve shqiptarë.

"Jam i sigurt që ju jeni argëtuar mjaft kohët e fundit me flamingot", tha Rama, duke shtuar se Shqipëria ka bërë përparim gjatë dekadës së fundit dhe se qytetarët tashmë presin më shumë nga vendi.

Sipas kryeministrit, Shqipëria ka kaluar nga një periudhë ku njerëzit mendonin se gjërat mund të përkeqësoheshin, në një fazë ku besojnë se gjërat mund të bëhen më mirë.

"Ky është revolucion i rritjes së pritshmërive. Njerëzit e kanë kuptuar që vendi e ka aftësinë për të kërcyer edhe më lart, të bëhet komplet ndryshe", u shpreh ai.

Rama foli edhe për shqetësimet e qytetarëve, duke përmendur pasiguritë, ankthin dhe atë që e cilësoi si përhapje të lajmeve të pasakta dhe teorive konspirative.

Në fjalën e tij, kryeministri theksoi se, ndryshe nga disa vende anëtare të BE-së, shqiptarët vijnë ta shohin anëtarësimin në Bashkimin Evropian si një objektiv të rëndësishëm.

"Ende e dashurojmë BE-në", deklaroi Rama, duke shtuar se pavarësisht debateve dhe mosdakordësive të brendshme, për një çështje shqiptarët janë të bashkuar.

"Për një gjë kemi rënë të gjithë dakord: për faktin që duam të jemi pjesë e Evropës dhe e dashurojmë Evropën", tha ai.

Në përfundim, Rama iu drejtua vendeve europiane me një apel për procesin e zgjerimit.

"Unë shpresoj shumë që mos të na lini përsëri në baltë sepse shkon përtej, është të lësh në baltë edhe vetveten. Nëse Evropa do të lërë në baltë BE, do të jetë dështimi më madhor", u shpreh kryeministri.

LAJMI I FUNDIT

11:03 Protestat në Madrid hyjnë në ditën e tretë pas dëbimit të pensionistes

11:02 Hamasi sulmon Ben-Gvirin pas kërcënimit për të vrarë të burgosurin palestinez

10:53 Vuçiq i dorëzon detyrën Ana Brnabić, kryetarja e Kuvendit merr përkohësisht drejtimin e Presidencës së Serbisë

SHPEJTIM: BE -ja harton plan veprimi për kandidatët premtues, mes tyre dhe Shqipëria

10:50 Ronaldo u la në stol, Portugalia fiton 2-1 ndaj Norvegjisë

10:42 Policia britanike kundër terrorizmit heton lidhjen e Iranit me komplotin e dyshuar me bombë në bazën RAF

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

EVROPA | LAJMI KRYESOR

BE -ja harton plan veprimi për kandidatët
premtues, mes tyre dhe Shqipëria

BE-ja po harton propozime që do t'u jepnin katër vendeve më të
afërta me bashkimin me bllokun një rrugë të qartë dhe hap pas
hapi...

10:51 | 28/09/2026

LAJMI KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Drejtësia refuzoi tryezën e Ramës, vjen
përgjigjia e Kryeministrit

Pas refuzimit të institucioneve të drejtësisë për të marrë pjesë në
tryezën e thirrur nga kryeministri Edi Rama për diskutimin e pagave
të magjistratëve, Kryeministria...

10:20 | 28/09/2026

AKTUALITET | LAJMI KRYESOR | VENDI

Pagat e magjistratëve, Shoqatat e Prokurorëve
dhe gjyqtarëve refuzojnë tryezën me Ramën:
Çështja ndodhet në Kushtetuese

Shoqatat e prokurorëve dhe gjyqtarëve kanë njoftuar se refuzojnë të
zhvillojnë një dialog me kryeministrin Edi Rama lidhur me çështjen e
pagave të magjistratëve. Shoqata...

09:48 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: